



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. 1079 Prot.

Elbasan 24.12.2024

RELACION

*“Për dhënie titulli “Qytetar Nderi”  
z.Ali Shashaj (pas vdekjes)*

Të nderuar këshilltarë!

“Bazuar në kërkesën e ardhur nga Universiteti”Aleksandër Xhuvani”, ish nxenës dhe ish-studentë të tij sot mësues e mësuese në të gjithë Shqipërinë. Ju paraqesim relacion për dhëni e titullit “Qytetar Nderi” profesorit Ali Shashaj.

Profesor Ali Shashaj ka lindur në Elbasan me date 5 Maj te vitit 1939. Mbasi mbaroi shkollen e mesme pedagogjike ne vitin 1956 ai filloi studimet në degën Gjuhë shqipe dhe letersi në fakultetin e Filologjisë ,Tiranë.Nga viti 1962 deri ne vitin 1988 ai ndoqi dhe dy kurse pas universitare. Ai mban tre grada shkencore: “Kandidat i Shkencave”, “Doktor i Shkencave” dhe “Asistent Profesor”.

Ai mban dy tituj “Urdhri Naim Frashëri” dhe “Mësues i Merituar”. Ai njihet si titullar dhe hartues i 11 programeve dhe leksioneve në fushen didaktike dhe gjuhesore. Ai numeron rreth 19 artikuj shkencor të botuar.

Nga viti 1980 deri ne vitin 1993 ai numëron rreth 13 studime te realizuara dhe 20 referata dhe kumtesa.Ai njihet si autor dhe bashkëautor i 10 teksteve universitare dhe i 6 teksteve për shkollën 9-vjecare.Të gjitha këto realizime te sipërpermendura profesor Ali Shashaj i ka mbështetur ne rrugetimin e tij akademik dhe profesional. Ky rrugetim akademik nisi me 1956 si mësues i gjuhës shqipe në shkollën fillore në fshatin Dragot të Elbasanit.Me 1963 ai kaloi si drejtore ne shkollën “Jorgji Dilo”, po ne te njeften kohe ai u be pjese e se ashtuquajtures “Rrethe metodike” per kualifikimin e mesuesve te gjuhes shqipe në Elbasan. Më 1980-1990 ai kaloi si mesues i gjuhes shqipe dhe i letersise në shkollën e mesme pedagogjike “Luigj Gurakuqi” dhe po në të njëjtën periudhë ai si drejtues i komisionit të lëndëve Gjuhë Shqipe dhe Letërsi në Elbasan. Në vitin 1976- 1990 ai filloi te punonte si pedagog në Institutin e Lartë Pedagogjik te Elbasanit. Ne vitin 1990 ai u pozicionua si pedagog me kohë të plotë në Universitetin “Aleksandër Xhuvani”.

Nga 1991-1996 ai mbajti detyren e Dekanit te Fakultetit të mesuesisë për klasat I-IV po ne tënëjtin universitet. Ai ka shërbyer si specialist pranë Ministrisë së Arsimit si anëtar i grupeve te punes per hartimin e programeve të lëndës së gjuhes shqipe dhe leximit letrar si dhe te shume

punimeve dhe realizimeve qe kurorëzuan të gjithe rrugëtimin e tij akademik dhe shkencor. Si rrjedhim: Bazuar në ligjin Nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore në Republikën e Shqipërise”, i ndryshuar Agjencia e Kulturës dhe Turizmit, ju paraqet relacionin për dhënien e titullit, “Qytetar Nderi” z.Ali Shashaj (pas vdekjes) “ Për kontributin e jashtëzakonshëm në edukimin dhe formimin e brezave të rinj, pasionin dhe përkushtimin e tij për arsimin, si dhe për rolin e tij të rëndësishëm në zhvillimin e dijes dhe kultivimin e vlerave didaktike dhe akademike”.

Bashkangjitur këtij relacioni do të gjeni dokumentacionin mbështetës.

Konceptoi: D.Kristo  
Pranoi: A.Guni


KRYETARI BASHKISË  
Gledian LLATJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Elbasan \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024

*Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit  
z.Ali Shashaj (pas vdekjes)*

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Agjensia e Kulturës dhe Turizmit (Sektori i Kulturës), “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit, z.Ali Shashaj mbështetur në nenin 54(gërmë “m”) të ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”(i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërmë “a” dhe pika 2, gërmë “b”) të ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. Ti jape titullin “Qytetar Nderi” i Elbasanit, z.Ali Shashaj, me motivacionin:
2. “**Për kontributin e jashtëzakonshëm në edukimin dhe formimin e brezave të rinj, pasionin dhe përkushtimin e tij për arsimin, si dhe për rolin e tij të rëndësishëm në zhvillimin e dijes dhe kultivimin e vlerave didaktike dhe akademike”.**
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**  
**Elvi ÇUNI**

**KRYETARI**  
**Lutfi LALA**

*Konceptoi:*  
Përgj. sek.Kulturës: D.Kristo  
Drejtoria Juridike: A. Hoxha  
Drejtës i A.K.T: A.Guni

Data 20.12.2024

## Kërkesë

Drejtar :Kryetarit të Bashkisë

Gledian Llatja

Drejtar: Agjencisë së Kulturës dhe Turizmit

Nga Komisioni Këshillimor

Lënda: Propozimi për ta nderuar prof. Ali Shashaj me titullin

"Qytetar Nderi" i Elbasanit (pas vdekjes)

Ky propozim mbështetet jo vetëm nga kolegët e bashkëpunëtorët e Universitetit "A.Xhuvani", por edhe nga mijëra e mijëra nxënës e nxënëse, ish-studentë e ish-studente të tij, sot mësues e mësuese në të gjithë Shqipërinë, të formuar dhe të modeluar sipas shembullit të profesorit.

Profesor Ali Shashaj është nderuar me:

**Titujt**

- “Urdhri Naim Frashëri”, dekret me nr.7111, Tiranë 02.03.1987
- “Mësues i merituar”, dekret me nr.1099, Tiranë 06.03.1995

Por, profesori është në kujtesën tonë si mësuesi i palodhur i Dragotit, Shtëpajës, e më pas i qytetit të Elbasanit (shkolla "Jorgji Dilo", shkolla e mesme pedagogjike "Luigi Gurakuqi", Elbasan), profesori i Institutit të Lartë Pedagogjik që nga viti 1976 (si i jashtëm), dhe që nga viti 1990 pedagogu i departamentit të gjuhësisë, por edhe dekani i palodhur, që nga viti 1991-1996. Ai është lektori i parë i kurseve që i themeloi vetë me punën e tij të palodhur:

- Metodikë e mësimit të leximit e të shkrimit dhe e gjuhës shqipe, në Fakultetin e Ciklit të Ulët
- Metodikë e gjuhës shqipe të shkollës 8-vjeçare, në Fakultetin e Shkencave Humane.

3. Psikologji e leximit dhe e shkrimit, në Fakultetin e Ciklit të Ulët
4. Tekstologji shkollore, në Fakultetin e Shkencave Humane dhe atë të Ciklit të Ulët
5. Zhvillim i aftësive linguistike në moshat e vogla (dega edukatore)

E gjithë kjo punë e madhe e ka bërë profesorin një nga emrat më të rëndësishëm në të gjithë Shqipërinë në fushën e vet. Ai është sot burim reference për fushat e mësipërme të studimit. Ai ishte në Elbasan një shtyllë për shkollën dhe shkencën për shkollën, ashtu si edhe emrat e mëdhenj të gjuhësisë së Elbasanit. Ai është një bir i denjë i Xhuvanit, Domit, Cipos. Qytetarët e Elbasanit duhet të jenë krenarë që e patën në gjirin e vet një intelektual të tillë, një shkencëtar të palodhur, një mësues të mirë dhe një njeri si prof. Ali Shashaj.

## CIVI

As / pr. Dr Ali Arif Shashaj

**Datëlindja:** 05. 05. 1939

**Vendlindja:** Elbasan

**Vendbanimi:** Elbasan

### Arsimi:

1. Shkolla e mesme Pedagogjike Elbasan (1956)
2. Universiteti i Tiranës, Fakulteti Filologji, dega gjuhë shqipe dhe letërsi

### Studime pasuniversitare:

1. Kurs pasuniversitar në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Tiranës (1962)
2. Kurs pasuniversitar në kërkim të gradës shkencore <Kandidat i Shkencave> në Fakultetin e Filologjisë të Universitetit të Tiranës(1987-1988)

### Grada shkencore:

1. < Kandidat i Shkencave>, nr i vendimit 191, Tiranë, datë 04 03 1989
2. < Doktor i Shkencave>, nr i regjistrat themeltar 2205, Tiranë, 1963
3. < Asistent Profesor>,nr i vendimit 9, Tiranë, 18 11 1994

### Tituj:

1. < Urdhri Naim Frashëri>, dekret nr 7111, Tiranë, 02 03 1987
2. < Mësues i Merituar>, dekret nr 1033, Tiranë,1995

### Detyrat në punësim:

1. Mësues i shkollës fillore në fshatin Dragot të Elbasanit; mësues i gjuhës shqipe në shkollën 7-vjecare të fsahatit Shtëpaj të Elbasanit dhe drejtor i saj (1956-1963)
2. Mësues i gjuhës shqipe dhe i letërsisë dhe me detyrën drejtor në shkollën 9-vjecare (për disa vite shkollë 11-vjecare) "Jorgji Dilo" Elbasan (1963-1980)
3. Njëherazi me detyrat e pikës 1 dhe 2, drejtues i të ashtuquajturave < rrthe metodike> për kualifikimin e mësuesve të gjuhës shqipe në Elbasan
4. Mësues i gjuhës shqipe dhe i letërsisë në shkollën e mesme pedagogjike "Luigj Gurakuqi" Elbasan (1980-1990) dhe drejtues i < komisionit të lëndëve gjuhë shqipe dhe letërsi> në Elbasan
5. Pedagog i jashtëm në Institutin e Lartë Pedagogjik < A Xhuvani> Elbasan (1976-1990)
6. Pedagog në Universitetin < A Xhuvani> Elbasan, departamenti i gjuhës shqipe (1990 dhe sot); ndërkohë dekan i Fakultetit Mësuesi për klasat I-IV në këtë universitet (1991-1996)
7. Pjesëmarrës në grupet e punës (me speciaslistë) pranë Ministrise së Arsimit dhe Institutit të Studimeve Pedagogjike Tiranë për hartimin e programeve të lëndës së gjuhës shqipe dhe të leximit letrar, si dhe të disa teksteve mësimore për këto lëndë për klasa të shkollës 8-vjecare (1967-1985)

- 14 < Për një konceptim konkret dhe optimal të edukatës gjuhësore, të zhvillimit të të folurit në arsimin parashkollar>, seminar I drejtorisë arsimore Librazhd, 1989
- 15 < Shkolla Normale për arsimin kombëtar>, sesion shkencor për 90 vjetorin e Normales, Elbasan, 2000
- 16 < Zgjedhje të karakterit didaktik gjuhësor të Kristoforidhit>, bashkëautor, Konferencë mbarëkombëtare, Prishtinë, 2001
- 17 Aspekte psiko-linguistike dhe sociolinguistike të modernizimit shkencor e pedagogjik të mësimit të gjuhës amtare>, seminar në “Universita degli studi di Lecce”, Dipartamento di Science Pedagogiche, didattiche, Lecce, 1999
- 18 < M Montesori, referim për të lexuarit dhe të shkruarit e parashkollorëve>, sesion shkencor jubilar, U E, Fakultetit i Mësuesisë, prill 2007
19. <Shkollë shqiptare me karakter kombëtar dhe me orientim evropian>, sesion shkencor jubilar për 10 vjetorin e shkollës “Imelda Lambertini, Elbasan, 2008
- 20 <Ndihamesa e Shkollës Normale dhe, e pandarë me të, e ushtrimores aty për shkollën shqiptare>. Konferencë shkencore ndërkombëtare, U E dhe Qendra e Studimeve Albanologjike, Elbasan, dhjetor 2009

#### **Tekste universitare**

1. <Metodikë e mësimit të gjuhës shqipe>, bashkëautor, U T, 1981
2. < Metodikë e mësimit të gjuhës shqipe>, bashkëautor, U T, 1986
3. <Didaktikë e mësimit të leximit e të shkrimit dhe e gjuhës shqipe> (kll-IV), botuar “Onufri”, Elbasan, 1994
4. < Zhvillimi i të folurit në moshën parashkollore>, botuar “ Onufri”, Elbasan 1996
5. <Nga të folurit në të lexuar>, botuar A E D P, Tiranë, 2000
6. <Ushtrime gjuhësore>, botuar “Onufri”, 1996
7. <Shkolla Normale e Elbasanit, bazë e arsimit kombëtar>, “Onufri”, 2000
8. <Metodikë e mësimit të gjuhës amtare>, botuar “ ADA”, Tiranë, 2005
9. < Kur arsimi lëvronte shpirtin>, grup autorësh, shtëpia botuese “Flesh” 2002
10. <Këndvështrime për të lexuarit dhe të shkruarit në moshat e vogla>, ( në proces botimi), shtëpia botuese “Print”, Tiranë 2009

#### **Tekste për shkollën 9-vjecare:**

1. < Vërej, veproj dhe lexoj e shkruaj>, shtëpia botuese “Sejko”, Elbasan
2. < Abetare, *Kacamici*>, botuar “Erik”, Tiranë 2004
3. <Fletore ushtrimesh për metodën e mësimit të leximit e të shkrimit”, botuar “Erik”, Tiranë 2004
4. <Kuptoj, lexoj dhe shkruaj>, shtëpia botuese “ Morava>, Tiranë 2009
5. <Gjuha amtare 7>, shtëpia botuese “Erik”, Tiranë 2007
6. <Gjuha amtare 8>, shtëpia botuese “Morava”, 2009

## **Titullar i lëndëve, hartues i prograve dhe i leksioneve përkatëse:**

1. Metodikë e mësimit të leximit e të shkrimit dhe të gjuhës shqipe, dega mësuesi (kl I-IV)
2. Metodikë e mësimit të gjuhës shqipe në shkollën 9-vjecare, dega mësues për gjuhën shqipe.
3. Gjuhë shqipe I, dega mësuesi (kl I-IV)
4. Leksikologji , fakulteti Shkencave Humane, dega gjuhë shqipe dhe letërsi
5. Fonetikë, fakulteti Shkencat Humane,dega gjuhë shqipe dhe letërsi
6. Didaktikë e edukimit gjuhësor, dega mësuesi parashkollore
7. Zhvillimi i aftësive linguistike (të folurit), dega mësuesi parashkollore
8. Psikologji e leximit dhe e shkrimit, dega mësuesi (kl I-IV)
9. psikologji e leximit dhe e shkrimnit, dega mësuesi parashkollore.
10. Tekstologji shkollore për gjuhën shqipe (kl I-IV)
11. Tekstologji shkollore për gjuhën shqipe (kl VI-IX)

## **Veprimtari botuese:**

### **Artikuj në organe shkencore:**

1. <Probleme të kulturës gjuhësore të fëmijëve>, revista “Gjuha jonë”, nr 4, Tiranë, 1987
2. <Drejtime dhe probleme të drejtshkrimit dhe të përdorimit të pikësimit të nxënësve>, revista “Gjuha jonë”, numër përbledhës, 1991
3. < Niveli i zhvillimit gjuhësor të fëmijëve të moshës parashkollore>, “Revista pedagogjike” I S P, nr 2,
4. <Zhvillimi i katër pjesëve nga leximi letrar>, I S P, buletini <Lëndët e shkencave shoqërore në shkollë>,nr 4, Tiranë,1967
5. <Organizimi i përforcimit dhe i përsëritjes me detyra krijuese dhe diskutime>, I S P, buletini <Lëndët e shkencave shoqërore në shkollë>, Tiranë, 1968
6. <Aspekte të forcimit të karakterit edukativ në mësimin e gjuhës shqipe>, I S P buletini <Lëndët eshkencave shoqërore në shkollë>, Tiranë, 1968
7. <Drejtime dhe probleme të përsëritjes në lëndën e gjuhës shqipe>, I S P, buletini <Gjuha dhe letërsia në shkollë>, nr 10
- 8 <Për një konceptim konkret të punës për edukatën gjuhësore të parashkollarëve>, I S P, buletini <Edukimi parashkollar>, 1989
- 9 < Nga të folurit gojor në lexim, një drejtim kryesor i punës në arsimin parashkollar>, Revista < Parashkollarët>, Tiranë, nëntor 1990
- 10 <Vecori të mësimit të gjuhës amtare sipas grupmoshave të moshës parashkollore>, I S P, buletin <Parashkollarët>, 1990
- 11 < Probleme të mësimit të gjuhës shqipe në klasat e ulëta të shkollës 8-vjecare>, I S P, buletini < kl. I-IV>, Tiranë 1990
- 12 <Përsëritja, drejtimet dhe shtrirja e saj në përbërësit e mësimit të gjuhës shqipe>, I S P, buletini < kl I-IV> nr 16
- 13 <Zhvillimi i të folurit me gojë e me shkrim kërkon punë të diferencuar> I S P, buletini <kl I-IV>, nr 20
- 14 <Arritje dhe probleme të programeve dhe të teksteve mësimore të mësimit të gjuhës shqipe>, Universiteti “L Gurakuqi” buletin special, Shkodër 1998
- 15 <Testimi në mësimin e gjuhës shqipe>, buletini U E, nr 2, Elbasan 1997
- 16 <Nga të folurit në të lexuar>, buletini U E, nr 1, Elbasan, 1998
- 17 < Përvijim i disa koncepteve bashkëkohore për hartimin “ Abetare” mbarëkombëtare>, buletini U E, nr 1, Elbasan,2001
- 18 < Leximi dhe shkrimi në moshën parashkollore>, I S P, buletini <Edukimi parashkollar>, Tiranë, 2003

- 19 <këndvështrime të ushtrimeve në lëndën e gjuhës shqipe në klasat e ulëta>, I S P,  
<Kurrikula dhe shkolla>, Tiranë, 2003

### Studime të kryera

1. <Normat e vlerësimit të nxënësve në gjuhën shqipe>, botim i Min Ars, 1980
2. <Normat e vlerësimit të nxënësve në leximin letrar>, botim i Min Ars, 1980
3. <Program i gjuhës shqipe në shkollën 8-vjecare>, (grup pune), Min Ars, 1984
4. <Pjesë letrare për lëndën e leximit letrar>, (grup pune) I S P, Tiranë, 1986
5. < Studim mbi projektin e teksteve të reja të gjuhës shqipe (kl I-IV) Min Ars 1985-1987 (grup pune)
6. Studime mbi projektin “Abetare” me elementë globalë të K Xhumarit (grup pune) Min Ars, 1985-1987
7. <Fjala e rrallë> në rrethin e Elbasanit>, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 1977
8. <Toponimet në qytetin e Elbasanit>, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë 1978
9. <Leksiku i fëmijëve sipas grupmoshave>, 1985-1987
10. <Ndërtimet gramatikore nga parashkshkollorët>, 1887-1988
11. <Ligjërimi me gojë e me shkrim i nxënësve në rrethin e Elbasanit> Instituti Pedagogjik “A xhuvani” dhe Seksioni i arsimit Elbasan, 1989-1900
12. Plan mësimor në Fakultetin e Mësuesisë në U E, për degën Mësuesi I-IV me shtrirje kohore 4 vjet, 1992
13. Plan mësimor në Fakultetin e Mësuesisë në U E , për degën parashkollore, (degë e re) 1 993

### Referate dhe kumtesa

- 1 <Hartimet në shkollën 8-vjecare>, seminar kombëtar për mësimin e gjuhës shqipe, Tiranë, 1987
- 2 <Punën për zhvillimin e të folurit të fëmijëve sipas grupmoshave...>, seminar kombëtar, Tiranë, 1982
- 3 <Për përmirësime cilësore në edukatën gjuhësore në veprimtaritë e kopshtit>, seminar kombëtar, Tiranë dhe Elbasan, 1989
- 4 < Mbi përsëritjen në rubrikat “flasim” dhe “shkruajmë”, seminar rajonal, Elbasan, 1989
- 5 <Ndihamesa e Shkollës Normale për metodat e mësimit në shollën filllore>, sesion shkencor për 80-vjetorin e Shkollës Normale, Elbasan, 1989
- 6 <Probleme të drejtshkrimit dhe të përdorimit të pikësimit të nxënësve>, seminar, Universiteti “A Xhuvani”, Elbasan, 1990
- 7 <Gjuha shqipe 5, kritere të përbajtjes dhe të zbatimit>, seminar rajonal i drejtorisë së arsimit, Elbasan, 1988
- 8 <Universiteti i Elbasanit për edukatën qytetare në shkollë> seminar, U E, 1995
- 9 <Integrimi i lëndëve në klasat e ulëta të shkollës 8-vjecare>, seminar, U E, Fakulteti i Mësuesisë, 1989
- 10 <Probleme të të lexuarit në moshat parashkollore dhe të ulët shkollore>, konferencë kombëtare I “Fokus në të lexuar”, Tiranë, 1997
- 11 <Zhvillimi i të folurit të nxënësve përmes mësimeve të teksteve të gjuhës shqipe>, Konferencë kombëtarë II “Fokus në të lexuar”, Tiranë, 2000
- 12 <Arritje dhe probleme të mësimit të gjuhës shqipe>, seminar i drejtorisë arsimore, Elbasan, 1998
- 13 <Drejtime dhe përbajtje në edukatën gjuhësore në kopsht>, seminar i drejtorisë arsimore, Elbasan, 1998



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. 7084 Prot.

Elbasan 24.12.2024

### RELACION

**“Për dhënie titulli “Qytetar Nderi” (pas vdekjes)  
Znj. Antoneta Kristo**

Të nderuar këshilltarë!

Bazuar në kërkesën e ardhur nga Qendra e Artit-Elbasan në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit të Elbasanit, ju paraqesim kërkesën për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” të Elbasanit, Znj. Antoneta Kristo (pas vdekjes).

Antoneta Apostol Kristo u lind më 9 Mars 1927 në qytetin e Korçës. Pas një fëmijërie të vështirë me humbjen e të atit, asaj iu desh të punonte që në moshë të re, po ashtu shumë shpejtë ajo filloj të rreshtohej në rradhët e ushtrisë Nacional Çlirimtare deri në vitin 1943 ku dha kontributin e saj për çlirimin e vendit. Nga viti 1945 Antoneta kontribuoi në organizimin e emancipim e rinisë. Ajo si aktiviste e rinisë dhe gruas ka punuar ne sektore mjaft të vështirë si nafta e më vonë Kombinati Tekstil i Tiranës. Më pas ajo u zhvendos ne sektorin e shëndetësisë në Elbasan, ku spikati për organizimin e lëvizjes amatore të grupeve artistike të shëndetësisë dhe pranë Shtëpisë Kulturës Elbasan, Në krijimin e Teatrit Skampa Ajo kalon si aktore profesioniste e Teatrit Skampa 1962 dhe punon aty deri në daljen në pension në vitin 1977. Ajo mban disa medalje pune dhe medaljen “Naim Frashëri”. Në rrugëtimin e saj artistik ajo njihet për disa interpretimet ne dramë e komedi.

Si dhe individualizimin e suksesshem të figurës së nënë shqipëtare ku nuk harrohet roli Xheja – tek “Udha e Zavalinajve”... Nanë Lokja tek “Cuca e Maleve” “Katër nga Armata” “Njeriu qe pa avdekjen” “dhe shumë figura të tjera shqipëtare. Me talentin, përkushtimin dhe pasionin e saj për teatrin Antoneta bëhet shembulli i këmbënguljes dhe realizimit me cilësi artistike në interpretimet e saj. Interpreton në 60 drama e komedi shqipëtare e të huaja. Ku ajo dallon për qëndresën, qartësinë, mjetet shprehese, diksionin e pastër në interpretimet e personazheve dhe karaktereve të ndryshme. Ajo ka konsoliduar emrin e saj në Teatrin Skampa, këtë e dëshmon edhe me vlerësimet që ajo mban si : ”Medalja e Çlirimit” ”Medalja e Punës” dhënë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Si rrjedhim, bazuar në ligjin Nr.112/2013 ”Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Agjencia e Kulturës dhe Turizmit, ju paraqet relacionin për dhënien e titullit, ”Qytetar Nderi” Znj. Antoneta Kristo (pas

vdekjes) me motivacionin: “Për kontributin e dhënë në krijimin dhe konsolidimin e teatrit Skampa dhe mishërimin e rolit të nënës shqiptare, në skenë e në kinematografi”.

Bashkangjitur këtij relacioni do të gjeni dokumentacionin mbështetës.

Konceptoi: D.Kristo




Pranoi: A.Guni



KRYETARI BASHKISE

Gledian LLATJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Elbasan \_\_\_\_ .2024

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë: \_\_\_\_ .2024

*Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit  
Znj.Antoneta Kristo (pas vdekjes)*

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ .2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Agjensia e Kulturës dhe Turizmit (Sektori i Kulturës), “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit, Znj.Antoneta Kristo (pas vdekjes) mbështetur në nenin 54(gërmë “m”) të ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”(i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gërmë “a” dhe pika 2, gërmë “b”) të ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

- 1.Ti japë titullin “Qytetar Nderi” i Elbasanit, **Znj.Antoneta Kristo (pas vdekjes)**, me motivacionin:
- 2. “Për kontributin e dhënë në krijimin dhe konsolidimin e teatrit Skampa si dhe mishërimin e rolit të nënës shqiptare, në skenë e në kinematografi”.**
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**  
**Elvi ÇUNI**

**KRYETARI**  
**Lutfi LALA**

*Konceptoi:  
Përgj sek.Kulturës: D.Kristo  
Drejtoria Juridike: A. Hoxha  
Drejtori i A.K.T: A.Guni*

*5554  
20.11.24*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
QENDRA E ARTIT**

Nr \_\_\_\_\_ prot

Elbasan më, \_\_\_\_ / \_\_\_\_ / 2024

**Lënda:** Kërkesë për dhënie Titulli "Qytetar Nderi i Elbasanit"

**Drejtuar:** Këshillit Bashkiak Elbasan *✓*

**Për dijeni:** Kryetarit të Bashkisë Elbasan

Zotit Gledian Llatja

I nderuar zoti Kryetar i Bashkisë!

Qendra e Artit – Bashkia Elbasan, në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit të Atdheut, si dhe bazuar në ligjin Nr.112/2013 "Per dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore në Republiken e Shqiperise", i ndryshuar, ju paraqet kërkesën për dhenien e titullit "Qytetar Nderi i Elbasanit" artistes **Antoneta Kristo**.

E ardhur nga teatri partizan, aktivizohet në lëvizjen amatore e më pas, fiton konkursin dhe pranohet aktore profesioniste në krijimin e teatrit profesionist Skampa qysh më 1962.

Nis kështu, një rrugëtim të suksesshëm në realizimin e shumë figurave artistike, sidomos, në individualizmin e figurës së nënës shqiptare në dramat e vëna në skenën tonë. Nuk harrohet Xheja tek "Udha e Zavalinajve" ...nanë Lokja tek "Cuca e maleve" "4 nga armata", "Njeriu që pa vdekjen" e shumë e shume figura të tjera të gruas shqiptare. Me talentin, përkushtimin dhe pasionin e saj për teatrin, Antoneta bëhet shëmbull i këmbënguljes dhe realizimit me cilësi artistike në interpretimet e saj. Interpreton në 60 drama e komedi shqiptare e të huaj, ku spikat qëndresa, qartësia, mjetet shprehëse, diksion i pastër në interpretimet e personazheve e karaktereve të ndryshme. Ajo ka konsoliduar emrin e saj në teatrin Skampa. Antoneta Kristo mban "Medaljen e Çlirimit dhe Medaljen e Punës dhenë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor

Motivacioni: "Për kontributin e dhënë në krijimin dhe konsolidimin e teatrit si dhe për krijimin me vërtetësi të nënës shqiptare në skenë e në kinematografi".

Jeta e profili saj artistik, shëmbull për më të rinjtë.

Serioziteti, përkushtimi, profesionalizmi dhe fisnikëria e kësaj gruaje është baza mbi të cilën bëhet edhe kjo kërkesë për dhënien e tiullit “Qytetar Nderi i Elbasanit” duke qene se artistja me pasionin e saj ka reflektuar gjithnjë mirësi **si një nga artistet më të shquara të qytetit tonë dhe me gjërë**. Duke ju falenderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin, shpresojmë se kërkesa jonë do të merret në konsideratë.



Antoneta Apostol Kristo, Lindur ne 9 Mars 1927 Korce.

Mbas humbjes se babait kur ishte e vogel ajo kaloj nje femiri te veshtir, qe ne mosh te re ju desh te punonte, shum shpejt ajo aktivizohet me rinin anti fashiste edhe shum shpejte reshtohet ne radhet e UNC ne vitin 1943 deri ne clirim e vendit.Antoneta mban dekoraten veterane te ushtris UNC,mbas vitit 1945 Antoneta kontriboj ne rindertimin edhe emancipimin e rinis.Antoneta si aktiviste e rinis dhe e gruas ka punuar ne sektore te veshtir, si nafta me von ne kombinatin tekstil te tiranes .

Mbas ardhjes ne sektorin e shendetsis ne Elbasan ajo dallohet ne organizimin e levizjes amatore te grupeve artistike te shendetsis edhe pran shtepis te kultures te elbasanit.Me krijimin e tetrir skampa ajo kalon Aktore profesjoniste e teatrit skampa ne vitin 1962, dhe punon deri ne daljen ne pension.Ajo mban medalje pune dhe medaljen Naim Frasherri.

Del ne pension ne vitin 1977

Ne vitin 2002 eshte mire qe jetes  
Hudore Chetnik  
T 2002

Antoneta Apostol Kristo.

Lindur me 9 Mars 1927 ne Korce.

Mbas humbjes se babait, kur ishte ende e vogel, ajo kaloi nje femijeri te veshtire.

Qe ne mosh te re, ju desh te punonte.

Shume shpejt ajo aktivizohet me rinine anti fashiste edhe reshtohet ne radhet e ushtrise NACL ne vitin 1943 deri ne clirimini e vendit.

Mbas vitit 1945 Antoneta kontribuoi ne rindertimin edhe emancipimin e rinise.Antoneta si aktiviste e rinise dhe e gruas, ka punuar ne sektore te veshtire, si nafta dhe me vone ne kombinatin tekstil te Tiranes . Me ardhjen ne Elbasan punoi ne sektorin e shendetesise dhe aty, ajo dallohet ne organizimin e levizjes amatore te grupeve artistike te shendetisise prane Shtepise te kulturesdhe krijmtarise popullore ne Elbasanit.Me krijimin e Tetrir Skampa, ajo kalon aktore profesioniste e Teatrit Skampa qe ne krijimin e tij ne vitin 1962.

Del ne penson ne vitin 1977. Vdes ne vitin 2002.

Ajo mban medalje pune.

Medaljen“Naim Frasher“

Antoneta mban dekoraten veterane te ushtris NACL.

Antoneta Apostol Kristo.

Lindur me 9 Mars 1927 ne Korce.

Mbas humbjes se babait, kur ishte ende e vogel, ajo kaloi nje femijeri te veshtire.

Qe ne mosh te re, ju desh te punonte.

Shume shpejt ajo aktivizohet me rinine anti fashiste edhe reshtohet ne radhet e ushtrise NACL ne vitin 1943 deri ne clirimini e vendit.

Mbas vitit 1945 Antoneta kontribuoi ne rindertimin edhe emancipimin e rinise.Antoneta si aktiviste e rinise dhe e gruas, ka punuar ne sektore te veshtire, si nafta dhe me vone ne kombinatin tekstil te Tiranes . Me ardhjen ne Elbasan punoi ne sektorin e shendetesise dhe aty, ajo dallohet ne organizimin e levizjes amatore te grupeve artistike te shendetisise prane Shtepise te kulturesdhe krijmtarise popullore ne Elbasanit.Me krijimin e Tetrir Skampa, ajo kalon aktore profesioniste e Teatrit Skampa qe ne krijimin e tij ne vitin 1962.

Del ne penson ne vitin 1977. Vdes ne vitin 2002.

Ajo mban medalje pune.

Medaljen“Naim Frasher“

Antoneta mban dekoraten veterane te ushtris NACL.

**Role të luajitura nga aktorja Antoneta Kristo.**


Nr	Personazhi	Drama	Autori	Regjisorë	Viti
1.	Rabija, e shoqja Feridit.	Rrethimi i bardhë.	Naun Prifti.	Lec Shllaku, / as. Thoma Kristo.	1962
2.	Zonja e senatorit Hermelius	Në Tufan.	Fadil Paçrami.	Lec Shllaku.	1963
3.	Tringa, nana e Delisë	Justina.	Hella Vulijoki.	Miho Gjini.	1963-1964
4.	Nana e Pirros.	Shtatë Shaljanët.	Ndrek Luca.	Lec Shllaku.	1963-1964
5.	Zonja Filimon	Linda.	Xhemal Broja.	Lec Shllaku.	1964
6.	Missis Bartvik, (gruaja e tij).	Njeriu që pa vdekjen me sy	Viktor Eftimiui.	Lec Shllaku.	1965
7.	Tuzikova.	Kutia prej argjendi.	Xhon Gollsuorthi	Miho Gjini.	1964-1965
8.	Nana Ishe.	I pesti u zu gjallë.	A. Salinski,	Lec Shllaku.	1965
9.	.....	Udha e largët.	Kastriot Zoraqi.	Lec Shllaku.	1966-1967
10.	.....	Udha e largët.	Aleksej Arbusov	Lec Shllaku.	1966
11.	Hatixheja e shoqja.	Udha e Zavalinajve.	Thanas Borodani.	Lec Shllaku.	1967
12.	Lemja – e ëma e Diellës.	Hijet ikin nga malet.	Vath Koreshi.	Lec Shllaku.	1967
13.	Lokja	Katër nga armata.	Serafin Fangu.	Xhelal Bilali.	1968
14.	Tringa - nana e Delisë	Skëndërbueu.	Lec Shllaku.	Lec Shllaku.	1968
15.	Shaqiq, e shoqja e Qazimit Shkrepit.	Gardhi.	Behexhet Çerma.	X helai Bilali.	1968
16.	Maria – puntore në fabrikë.	Projekti.	Tomorr Himçi.	Tomorr Himçi.	1968
17.	Maria - puntore e vjetër	Firmat e vogla.	Thanas Borodani.	Lec Shllaku.	1968
18.	Nana	Qelia nr 7.	Jordan Haxhinikolla.	Lec Shllaku.	1969
19.	.....	Shqetësimet e Sokratit.	Lec Shllaku.	Lec Shllaku.	1969
20.	Manushaqja - ëma e Petritit	Drita	Mimika Luca.	Tefta Hamzraj.	1970
21.	Teto Belkizja – pensioniste.	Sinjalitet e natës.	Fadil Kraja.	X helai Bilali.	1970
22.	Mara.	Gadrat.	Kolë Jakova.	Lec Shllaku.	1970
23.	Adifeti, sanitare.	Fundi i një intrige.	Shpëtim Shmili.	Xhelal Bilali.	1971
24.	Dafina	Familja e peshkatarit.	Sulejman Pitarka.	Drita Agolli. As/T. Shishmani.	1971
25.	Marija	Orteku.	Ruzhdì Qatipi.	Tomorr Himçi.	1972
26.	.....	Viti 61.	Fadil Paçrami.	Tomorr Shishmani.	1973
27.	Prenda – e ama e Cucës	Cuca e maleve.	Loni Papa.	Xhelal Bilali.	1973
28.	Nazja, e shoqja.	Për jetën.	Thanas Borodani.	Xhelal Bilali.	1973
29.	Qytetarja	Prefekti.	Besim Lëvonja.	Xhelal Bilali.	1974
30.	Irena, e shoqja, arsimtare	Familjet e mëdha.	Sheri Mita.	Tomorr Himçi.	1974
31.	Afërdita.	Vellezërit.	Miliano Stefa.	Xhelal Bilali.	1975
32.	Nëna (Nëna e heroit Bujar).	Gërmëra në gur.	Tomorr Himçi	Tomorr Himçi	1975
33.	Halla, Halla e Hodos	Hakmarija e madhe.	Astrit Çerma.	Xhelal Bilali.	1976
34.	Zylyfa, kiente e Qamos.	Telefoni Paralel.	Dionis Bubani.	Xhelal Bilali.	1977

Nr	
----	--

### Personazhi Olimbi Bilali

Nr	Personazhi Olimbi Bilali	Autori	Regjisori	Viti
1.	Meri, teknike e mesme.	Drama	Riethimi i bardhë.	Naun Prifti.
2.	Emira, një e re, 20 vjeç		Në Tufan.	Fadil Paçrami.
3.	Baronesha		Justina.	Hella Vulijoki.
4.	Mrijja, motra e Delisw		Linda.	Shtatë Shaljanët.
5.	Linda, puntore		Njeriu që pa vdekjen me sy	Hella Vulijoki.
6.	Zonjusha Alis		Kutia prej argjendi.	Mihal Broja.
7.	Missis Xhouns, (shërbëtore tek Bartvillët).		Trumbetjerja.	Viktor Eftimiu.
8.	Zonja Paramanova.		I pesti u zu gjallë.	Xhon Gollsuorthi
9.	.....		A. Sallinski,	Miho Gjini.
10.	Bardha e bija, puntore.		Kastriot Zoraci.	Lec Shllaku.
11.	Hairrija – nusja e Arifit.		Udha e Zavalinajve.	Lec Shllaku.
12.	Ana		Hijet ikin nga malet.	Thanas Borodani.
13.	Mara.		Katër nga armata.	Vath Koreshi.
14.	Dilja.		Skrëndërebu.	Serafin Fangu.
15.	Valentine, inxhiniere		Gardhi.	Lec Shllaku.
16.	Shpresa, e shoqja e Qazimit		Projekti.	Xhelal Bilali.
17.	Drita, antare e njesitit gueril		Behexhet Çerma.	Lec Shllaku.
18.	.....		Firmat e vogla.	Xhelal Bilali.
19.	Burbugja – mjeke.		Qelia nr 7.	Tomorr Himçi.
20.	Filja.		Shqetësimet e Sokratit.	Thanas Borodani.
21.	Marta, punonjëse e organizatës së gruas.		Sirjalet e natës.	Jordan Haxhinikolla.
22.	.....		Gadrat.	Lec Shllaku.
23.	Dafina		Fundi i një intrige.	Fadil Kraja.
24.	Zina, e shoqja e Petritit		Familjia e peshkatarit.	Kolë Jakova.
25.	Cuca.		Orteku.	Shpëtim Shmili.
26.	Sultana, e shoqja		Viti 61.	Sulejman Pitarka.
27.	Katerina, gruaja e doktorit		Cuca e maleve.	Ruzhdi Qatipi.
28.	Violeta, e shoqja e Qazuas, edukatore.		Për jetën.	Fadil Paçrami.
29.	Urania (Pensioniste, veterane lufte).		Prefekti.	Loni Papa.
30.	Reti (Kooperativiste).		Familjet e mëdha.	Thanas Borodani.
31.	Nëna		Vëllezërit.	Besim Lëvonja.
32.	Halla.		Gërmë në gur.	Sheri Mita.
33.	( Halla e Hodos).		Zani Partizani.	Milano Stefa.
34.	Rukka, e shogja			Tomorr Himçi
35.	.....			Xhelal Bilali.
36.	Dhoksi, motra e Kristinës, 44 vjeç,			Tomorr Himçi
				1975
				1975
				1975
				1975
				1976
				1976
				1976

	mësuese.			
37.	Valdetti, infermiere, rreth 40 vjeç.	Doktori Pacient.	Ruzhdi Pulaha.	Xhelal Bilali, As/Astrit Çerma (A. P.)
38.	Vera – teknike.	Vera e vitit 78.	Bahri Myftari.	Tomorr Shishmani.
39.	Gruaja	Shpagimi.	Ilir Bezhani.	1978
40.	Bihana – e ëma e Zinës.	Në prag të jetës.	Fahri Balliu.	1979
41.	punëtore	Telefoni në mesnatë.	Kadri Pirro.	1980
42.	Raba. e shoqja e Ramws.	Tokë e ndezur.	Fahri Balliu.	1980
43.	Gruaja.	Gjëmimet e një vjeshte.	Tomorr Shishmani.	1981
44.	Zonja. Rondi – e shoqja e Fransuait, puntore.	Flakët.	Fahri Balliu.	As/ Sabaudin Bordi.
45.	Kadria – nëna e Kadriut.	Na duhet një magnetofon.	Fahri Balliu.	Astrit Çerma.
46.		Mirushi dhe shokët e tij.	Shpëtim Shëmili.	1982
47.	Zonja e madhe, nwna e Serafinws.	Përtej Dashurisë.	Dashnor Kokonozi.	Dhimosten Papa. As/Z. Begolli.
48.	Kamarierë të pietores që nuk flasin.	Shërbëtori i dy zotërinjve.	Karlo Goldon.	Tomorr Shishmani. as/Pertef Larti.
49.	Meremja, e shoqja e Haxhiut.	Dy krisma në Paris.	Pëllumb Kulla, Sheri Mita.	1982
50.	Violeta (Mamaja, inspektoreshë çerdhësh).	Telashet e një ndeshje.	Shpëtim Shmili.	Spiro Duni. As/Shpëtim Shmili
51.	Halla Suta	Vvilezur tw njw gjaku	Astrit Bishqemi. Dh. Papa	1983
52.	Sania	Shtegu i zënë.	Dhimonsten Papa.	1984
53.	Shpresa.	Fahri Balliu.	Spiro Duni. As / Eduart Çala.	1985
54.	Helenë Melvin	Zemër e shqetësuar.	Shpëtim Shëmili(A.M.).	1986
55.	Tati	Engjëjt e Skëterrës.	Pol Kanteri, Zhorzh Bellak.	Shpëtim Shëmili, As / Pertef Larti.
56.	Fatimja – e shoqja.	Sa shumë gjithë të thata.	Spiro Duni. As / Tomorr Sulkja.	1987
57.		Në pushimet verore.	Spiro Duni. As / Benon Lopari.	1989
			Tomorr Himçi. As / Ilir Borodani.	1989



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. 1076 Prot.

Elbasan 24.12.2024

RELACION

*"Për dhënien titulli "Qytetar Nderi"  
z.Aristir Lumezi (pas vdekjes)*

Të nderuar këshilltarë!

"Bazuar në kërkesën e ardhur nga Asociacioni i Gazetarëve të Shqipërisë (AGSH), për vlerësimin e figurës së Aristir Lumezi, me një karierë të pasur prej dy dekadash, ka dhënë një kontribut të jashtëzakonshëm si gazetar në median e shkruar dhe vizive. Një nga detyrat më të rëndësishme të tij ka qenë roli si kryeredaktor i gazetës "Panorama", një nga gazetat më të rëndësishme shqiptare, detyrë të cilën e udhëhoqi me përkushtim dhe profesionalizëm të lartë. Përtej angazhimit të tij në media, Aristir Lumezi ka luajtur një rol të rëndësishëm edhe në formimin akademik të studentëve të gazetarisë, duke shërbyer si pedagog i jashtëm në Universitetin e Elbasanit, ku vetë ishte diplomuar për letërsi në vitet 1985-1989. Roli i tij si edukator dhe mentor i brezave të rinj ka lënë gjurmë të thella në gazetarinë Shqiptare. AGSH beson se shpallja e Aristir Lumezit si "Qytetar Nderi" I Elbasanit do të ishte një njojje e merituar për të gjithë kontributin që ai ka dhënë për gazetarinë dhe shoqërinë shqiptare. Një akt I tillë nderon jo vetëm veprën e tij të paharrueshme por edhe qytetin e Elbasanit, ku ai u formua dhe kontribuoi në arsimin dhe gazetarinë shqiptare, si rrjetdhim: Bazuar në ligjin Nr.112/2013 "Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore në Republikën e Shqipërise", i ndryshuar Agjencia e Kulturës dhe Turizmit, ju paraqet relacionin për dhënien e titullit, "Qytetar Nderi" z.Aristir Lumezi (pas vdekjes) "Për kontributin e tij të çmuar në gazetarinë shqiptare, si gazetar, pedagog dhe kryeredaktor, duke formuar breza të rinjsh profesionistë dhe duke udhëhequr me profesionalizëm dhe etikë, për avancimin e gazetarisë dhe informimin e saktë të publikut."

Bashkangjitur këtij relacioni do të gjeni dokumentacionin mbështetës.

Konceptoi: D.Kristo  
Pranoi: A.Guni

KRYETARI BASHKISË  
Gledian LLATJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Elbasan \_\_\_\_ .2024

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë: \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024

*Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit  
z. Aristir Lumezi (pas vdekjes)*

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Agjensia e Kulturës dhe Turizmit (Sektori i Kulturës), “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit, z. Aristir Lumezi (pas vdekjes) mbështetur në nenin 54(gérma “m”) të ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”(i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gérma “a” dhe pika 2, gérma “b”) të ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. Ti japë titullin “Qytetar Nderi” i Elbasanit, z. Aristir Lumezi (pas vdekjes) me motivacionin:
2. “Për kontributin e tij të çmuar në gazetarinë shqiptare, si gazetar, pedagog dhe kryeredaktor, duke formuar breza të rinjsh profesionistë dhe duke udhëhequr me profesionalizëm dhe etikë, për avancimin e gazetarisë dhe informimin e saktë të publikut.”
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**  
**Elvi ÇUNI**

**KRYETARI**  
**Lutfi LALA**

*Konceptoi:*  
Përgj. sek.Kulturës: D.Kristo  
Drejtoria Juridike: A. Hoxha  
Drejtori i A.K.T: A.Guni



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. 7081 Prot.

Elbasan 24.12. 2024

RELACION  
“Për dhënie titulli “Qytetar Nderi”  
z.Bukurosh Sfafa

Të nderuar këshilltarë!

"Bazuar në propozimin e Komisionit Këshillimor si dhe të kërkesave të tjera të ardhura, për vlerësimin e figurës dhe për dhënien e titullit të lartë "Nderi i Qytetit" Elbasan propozojmë pranë jush marrjen në konsideratë të vlerësimin e z.Bukurosh Ndriçim Stafa me titullin "Qytetar Nderi" i Elbasanit.

z.Bukurosh Stafa u lind në qytetin e Elbasanit më datë 26.07.1951. Arsimin fillor dhe te mesem e ka kryer ne qytetin e Elbasanit. Në vitin 1968-1970 ka punuar prane Kombinatin Metalurgjik Elbasan. Në vitin 1970-1974 vazhdoi studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Tiranës dega "inxhinieri Metalurgjike".

1974-1975 Ka shkuar per specializim ne Republikën Popullore të Kinës në degën e Metalurgjisë.

Ne vitin 1975-1976 ka punuar si inxhinier ne Uzinen e Çelikut ku nga 1976 deri më 1978 mbajti detyren e pergjegjes reparti.

1978-1980 emerohet Kryetar i Deges Teknike ne Uzinen e Çelikut

1980-1983 vazhdon studimet pasuniversitare në Gronobël – Francë ku mori titullin "Doktor për Shkencat Metalurgjike".

1983-1989 emerohet Krye-inxhinier në Drejtorinë e Përgjithshme te ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan.

1989-1992 emerohet Drejtor i Përgjithshëm në ish Kombinatin Metalurgjik Elbasan

Nga 1992-1997 ushtron profesionin e lire ne aktivitet privat

Nga viti 1999-2000 emerohet Drejtor i Alb-Kromit Tiranë

Në një legislaturë 4-vjeçare ka qenë Deputet i Kuvendit të Shqipërisë.


Nga viti 2017-2023 zgjidhet Anëtar i Këshillit Bashkiak si dhe votohet për Kryetar i Këshillit të Qarkut Elbasan, ku me 14 Maj 2023 u zgjodh sërisht por këtë here si anëtar i këtij Keshilli. Si rrjedhim bazuar në ligjin Nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore në Republikën e Shqipërise”, i ndryshuar Agjencia e Kulturës dhe Turizmit, ju paraqet relacionin për dhënien e titullit, “Qytetar Nderi” I Elbasanit z. Bukurosh Stafa me motivacionin “**Për kontributin e tij në fushën e metalurgjisë, zhvillimin e industrisë dhe angazhimin e tij të çmuar në administratën dhe politikën lokale, duke lënë një ndikim të qëndrueshëm në komunitetin e tij.**”

Bashkangjitur këtij relaciuni do të gjeni dokumentacionin mbështetës.

Konceptoi: D.Kristo  
Pranoi: A.Guni

  
**KRYETARI BASHKISË**  
**Gledian LLATJA**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
AGJENCIA E KULTURËS DHE TURIZMIT

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Elbasan \_\_\_\_ .2024

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë: \_\_\_\_ .2024

*Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit  
z. Bukurosh Stafa*

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ .2024, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Agjensia e Kulturës dhe Turizmit (Sektori i Kulturës), “Për dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit, **Z.Bukurosh Stafa** mbështetur në nenin 54(gëрма “m”) të ligjit nr.139/2015 “Për vetë qeverisjen vendore”(i ndryshuar), si dhe në nenin 15 (pika 1, gëрма “a” dhe pika 2, gëрма “b”) të ligjit nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. Ti japë titullin “Qytetar Nderi” i Elbasanit, **z.Bukurosh Stafa** me motivacionin:
2. “**Për kontributin e tij në fushën e metalurgjisë, zhvillimin e industrisë dhe angazhimin e tij të çmuar në administratën dhe politikën lokale, duke lënë një ndikim të qëndrueshëm në komunitetin e tij.**”
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administrata dhe Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**  
**Elvi ÇUNI**

**KRYETARI**  
**Lutfi LALA**

*Konceptoi:*  
Përgj. sek.Kulturës: D.Kristo  
Drejtoria Juridike: A. Hoxha  
Drejtori i A.K.T: A.Guni

19.12.2024

## Kërkësë

Drejtuar Bashkisë Elbasan

z.Gledian Llatja Kryetar

Drejtuar: Agjencisë së Kulturës dhe Turizmit

Nga Komisioni Këshillimor

### **Lënda: Propozim për dhënien titulli “Qytetar Nderi” i Elbasanit z.Bukurosh Ndriçim Stafa**

Ne si Komision Këshillimor propozojmë vlerësimin e figurës së z. Bukurosh Ndriçim Stafa dhënien e titullit “Qytetar Nderi” i Elbasanit.

z.Bukurosh Stafa u lind në qytetin e Elbasanit më datë 26.07.1951. Arsimin fillor dhe te mesem e ka kryer ne qytetin e Elbasanit. Në vitin 1968-1970 ka punuar prane Kombinatit Metalurgjik Elbasan. Në vitin 1970-1974 vazhdoi studimet e larta në Universitetin Shtetëror të Tiranës dega “inxhinieri Metalurgjike”.

1974-1975 Ka shkuar per specializim ne Republikën Popullore të Kinës në degën e Metalurgjisë.

Ne vitin 1975-1976 ka punuar si inxhinier ne Uzinen e Çelikut ku nga 1976 deri më 1978 mbajti detyren e pergjegjes reparti.

1978-1980 emerohet Kryetar i Deges Teknike ne Uzinen e Çelikut

1980-1983 vazhdon studimet pasuniversitare në Gronobël – Francë ku mori titullin “Doktor për Shkencat Metalurgjike”.

1983-1989 emerohet Krye-inxhinier në Drejtorinë e Përgjithshme te ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan.

1989-1992 emerohet Drejtor i Përgjithshëm në ish Kombinatin Metalurgjik Elbasan

Nga 1992-1997 ushtron profesionin e lire ne aktivitet privat

Nga viti 1999-2000 emerohet Drejtor i Alb-Kromit Tiranë

Në një legjislaturë 4-vjeçare ka qenë Deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Nga viti 2017-2023 zgjidhet Anëtar i Këshillit Bashkiak si dhe votohet për Kryetar i Këshillit të Qarkut Elbasan, ku me 14 Maj 2023 u zgjodh sërisht por këtë here si anëtar i këtij Keshilli.

Si rrjedhim bazuar në ligjin Nr.112/2013 “Për dekoratat, titujt e nderit, medaljet dhe titujt vendore në Republikën e Shqipërise”, i ndryshuar kerkesen për dhënien e titullit, “Qytetar Nderi” I Elbasanit z. Bukurosh Stafa me motivacionin **“Për kontributin e tij në fushën e metalurgjisë, zhvillimin e industrisë dhe angazhimin e tij të çmuar në administratën dhe politikën lokale, duke lënë një ndikim të qëndrueshëm në komunitetin e tij.”**

## **BUROSH NDRIÇIM STAFÄ**

**Datë lindja: 26.07.1951**

**Vend lindja: ELBASAN**

**Jetëshkrim i kandidatit (Curriculum Vitae)**

### **Arsimi:**

**I larte inxhinieri.**

- \* 1970-1974 studimet e larta Inxhinier Metalurg.
- \* 1974-1975 specializim pasuniversitar per metalurgjine e gelikut ne Shangai, Kinë.
- \* 1980-1983 studime pasuniversitare ne Grenobel, Francë ku merr titullin Doktor Inxhinier ne shkencat metalurgjike.


### **Eksperiencia ne punë:**

- \* 1968-1970 Punëtor ne fonderine e gizes Uzina Mekanike Elbasan
  - \* 1975-1976 Inxhinier ne Uzinën e Celikut te Kombinatit Metalurgjik Elbasan
  - 1976-1978 Pergjegjes i repartit te shkrirjes, Uzina Celikut, Kombinati Metalurgjik Elbasan.
  - 1978-1980 Kryetar i deges tekniqe, Uzina Celikut, Kombinati Metalurgjik Elbasan
  - 1983-1989 kryeininxhinier i Kombinatit Metalurgjik Elbasan 1989-1992  
Drejtor i Kombinatit Metalurgjik Elbasan 1992-1997 aktivitet privat
  - 1997-1999 Drejtor i Uzines së Ferrokromit Elbasan 1999-2000 Dreitor Albkromit, Tiranë
  - 2000-2005 Aktivitet privat, Administrator i Unionit Financiar Prishtine, Kosove.
  - \* 2005-2009 Deputet ne Kuvendin e Shqipërisë
  - 2009-2013 Aktivitet privat
  - \* 2013-2015 Drejtor Egzekutiv i Kompanise Celulare Plus comonication. •
  - 2015 – 2023 Kryetar i Keshillit të Qarkut, Elbasan.
- Anëtar I Keshillit Bashkiak për zgjedhjet per organet e Qeverisjes Vendore te dates 30 qershor 2019 në Qarkun Elbasan propozuar nga subjekti politik Partia Socialiste e Shaipërise

## **Kualifikimi:**

### **Aktivite shoqerore dhe politike:**

- \* 1990-1994 anëtar i Komitetit Drejtues të Partisë Socialiste Tiranë • 1992 kandidat per deputet i Partisë Socialiste Elbasan**
- \* 1996 kandidat per deputet i Partisë Socialiste Elbasan**
- \* 2005 kandidat per deputet i Partise Socialiste Elbasan**
- \* 2012 e ne vazhdim anëtar i Asamblesë kombëtare të Partise Socialiste te Shqipërise**



## Kërkesë

**Drejtar:** Këshillit Bashkiak -Bashkia **Elbasan**

**Për dijeni:** Kryesisë të Komisionit Këshillimor- Bashkia Elbasan  
Kryetarit të Këshillit Bashkiak Bashkisë **Elbasan**

**Zotit Lytfi Lala**

**Lënda:** *Kërkesë për dhënien Titulli "Nderi Qytetit Elbasanit"*

**Zotit Bukurosh Ndriçim Stafa**

Kryesia e Shoqatës Kombëtare Gorë & Opar e Bashkuar Shqipëri, Këshilli Drejtues, Këshilli Kombëtar i Shoqatës Gorë & Opar e Bashkuar Shqipëri. Kryesia e vlerësimit të figurave dhe simboleve,mbasi diskutoi me përgjegjësi patriotike dhe atdhetare, duke e miratuar edhe në mbledhjen e datës 12.09.2023, vendosi që t'i bëhet kërkesë Këshillit Bashkiak Bashkisë Elbasan për dhënien e titullit të lartë "Nderi Qytetit Elbasan", z. **Bukurosh Ndriçim Stafa**. Në mbështetje të Ligjit nr.139 dt.17.12.2015, nen 54 gërmë LL."Për Figurat dhe Simbolet" për Vetëqeverisjen Vendore, në rastin konkret në kompetencë të Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan.

Duke menduar dhe analizuar për vlerat dhe kontributet që ka dhënë **Z. Bukurosh Stafa**, gjatë gjithë jetës së tij në marrëdhënie pune, por edhe për një kontribut të madh që ka dhënë në mbështetje për Shoqatën Kombëtare Gorë & Opar e Bashkuar Shqipëri.

Zotit Bukurosh Ndriçim Stafa ka lindur në qytetin e Elbasanit më **dt.26.07.1951**. Arsimin fillor dhe të mesëm e ka kryer në Elbasan. Në vitin **1968-1970** ka punuar si punëtor në Fonderinë e Gizës, Uzina Mekanike ish Kombinati Metalurgjik Elbasan.

Më pas në vitet 1970-1974 ka vazhduar studimet e larta në Universitetin Shtetëror Tiranë në Fakultetin e Inxhinjerisë, **Dega inxhinjeri metalurgjike**. Në vitin 1974-1975 ka shkuan për specializim në Rep.Popullore të Kinës në Degën e Metalurgjisë.

Nga viti 1975-1976 ka punuar si specialist, ing.metalurg në Uzinën e Çelikut.

Nga viti 1976-1977-1978, emërohet përgjegjës reparti në Uzinën e Çelikut.

Nga viti 1978 -1980 emërohet Kryetar i Degës Teknike në Uzinën e Çelikut

Nga viti 1980-1983 vazhdon studimet pas Universitare në Gronobël-Francë i cili mori titullin "Doktor për Shkencat Metalurgjike"

Nga viti 1983-1989 emërohet Krye/inxhinjer në Drejtorinë e Përgjithshme të ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan.

Nga viti 1989-1992 emërohet Drejtor i Përgjithshëm në ish Kombinatit Metalurgjik Elbasan.

Nga viti 1992-1997 ushtron profesionin e lirë në aktivitet privat

Nga viti 1999-2000 emërohet Drejtor i Alb-Kromit Tiranë.

Në një legislaturë 4-vjeçare ka qenë Deputet i Kuvendit të Shqipërisë.

Nga viti 2017 – 2023 zgjidhet Anëtar i Këshillit Bashkiak si dhë votohet për Kryetar i Këshillit Bashkiak i Bashkisë Elbasan. Edhe në zgjedhjet e Pushtetit Vendor **14 Maj 2023** për Bashkinë Elbasan, zgjidhet sërisht Anëtar i Këshillit Bashkiak, Bashkia Elbasan.

Trajtim i materialit miratuar më \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_ / \_\_\_\_\_

Sekretari i Përgjithshëm \_\_\_\_\_

1917 prot.

date 25/11/2024  
Bashkia Elbasan

## KERKESË

### BASHKISË ELBASAN

Une i nenshkruari/a PLENER ART banues/e ne adresë Elbasan

Nr. tel \_\_\_\_\_ Cel. \_\_\_\_\_ dhe dokument identifikimi \_\_\_\_\_ nr. \_\_\_\_\_

Bazuar ne: Kodin e Procedurave Administrative dhe ligjin 119/2014 date 18.09.2014 "Per te drejten e informimit"

Kerkoj: llorelzëse për shtesën e titullit "Qytetar Nek Sadik Tcajto"

Kerkesen time e bazoj ne arsyetimin se :

(Empty space for written justification)

Bashkalidhur do te gjeni dokumentat e poshteshenuara :

1. \_\_\_\_\_
2. \_\_\_\_\_
3. \_\_\_\_\_
4. \_\_\_\_\_
5. \_\_\_\_\_

KERKUESI "PLENER ART"  
Firma

Elbasan me date 25/11/20

Duke shprehur konsideratën tonë të lartë, Grupimi i piktoreve peizaznisie "PLENER ART", themeluar në vitin 2015 dhe regjistruar në Gjykatën e Tiranës më datë 30. 06. 2015, me Numër 5122 Vendimi, ndjen detyrim të saj, t'ju propozojë vlerësimin me titullin "Nderi i Qytetit të Elbasanit" piktorit të njojur, zotit Saik Kasa.

Piktori Sadik Kasa është diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve në vitin 1977, në specialitetin "Piktor Skenograf". Që nga ajo kohë e deri sa doli në pension, ai ka punuar në sektorin e kulturës si Skenograf në Pallatin e Kulturës dhe drejtues i Galerisë së Arteve në Bashkinë e Elbasanit. Gjithashtu, për një dekadë, ka dhënë mesim edhe në shkollën e mesme artistike "Onufri" të këtij qyteti.



Grupi PleinAir Art Albania\*

më 15 nëntor 2024

## KËRKESË

Drejtar: Bashkisë Elbasan

Zotit Gledian Llatja, Kryetar

Këshillit të Bashkisë

Zotit Lytfi Lala, Kryetar

Nga: Grupimi i piktorëve peizazhistë "PLENER ART" Albania

Baza ligjore: Ligji nr, 139/2015 "Për vetqeverisjen vendore", Ligji nr. 94/2022 "Për titujt e nderit dhe titujt vendorëtë nderit në Republikën e Shqipërisë"

Lënda: Kërkësë për dhënie titulli "Qytetar Nderi" kolegut tonë, piktorit Sadik Kasa.

I nderuar zoti Kryetar!

Të nderuar anëtarë të këshillit!

Duke shprehur konsideratën tonë të lartë për Këshillin e Bashkisë Elbasan, i Grupimi piktorëve peizazhistë "PLENER ART", themeluar në vitin 2015 dhe regjistruar në Gjykatën e Tiranës më datë 30. 06. 2015, me Numër 5122 Vendimi, ndjen detyrim të saj, t'ju propozojë vlerësimin me titullin "Qytetar Nderi" piktorin e mirënjohur, zotin Saik Kasa.

Piktori Sadik Kasa është diplomuar në Institutin e Lartë të Arteve në vitin 1977, në specialitetin "Piktor Skenograf". Që nga ajo kohë e deri sa doli në pension, ai ka punuar në sektorin e kulturës si Skenograf në Pallatin e Kulturës dhe drejtues i Galerisë së Arteve në Bashkinë e Elbasanit. Gjithashtu, për një dekadë, ka dhënë mesim edhe në shkollën e mesme artistike "Onufri" të këtij qyteti.

Piktori Sadik Kasa, që nga mbarimi i studimeve e deri më sot, është një piktor me krijimtari të suksesshme dhe gjithnjë në rritje për nga cilesia dhe gama e shtrirjes së saj. Ai ka qënë prezent në ekspozitat e rëndësishme kombëtare që janë zhvilluar në Tiranë duke fituar edhe çmime kombëtare. Në vazhdimesi, është autor i shumë ekspozitave të hapura në Elbasan, Tiranë dhe jashtë vendit.

Me kontributin e tij artistik ka ndikuar së tepërmë në pasurimin e jetës artistike të qytetit të Elbasanit dhe është bërë modeli për tu ndjekur nga të rinjtë që aspirojnë fushën e artit. Peneli i tij i ka thurur hymn natyrës së bukur shqiptare duke e hedhur atë në telajo nga jugu në veri. Ai është dalluar si një peizazhist tipik. Pa as më të voglin dyshim, ai është një individualitet artistik në këtë gjini arti, duke e vendosur në rangun e peisazhistëve më të dalluar në vend.

Sadik Kasa vazhdon me të njëjtin ritëm të pikturojë natyrën. Ai e dashuron atë sepse është i lidhur pazgjidhshmërisht me atdheun e tij.

Veprat e tij janë në fondin e Galerisë së Arteve në Elbasan, në Galerinë Kombëtare të Tiranës dhe në koleksione të artit brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Për të gjitha arrijet e tij në fushën e arteve figurative, ne jemi besimplotë se Këshilli i Bashkisë Elbasan do ta marrë në konsideratë propozimin tonë, për ta vlerësuar piktorin Sadik Kasa me titullin “Nderi i Qytetit të Elbasanit”

**“Për kontributin e pamohueshëm në jetën artistike dhe kulturore, si një ndër artistët e rëndësishëm të qytetit, më një krijimtari të gjatë, të një niveli të lartë profesional dhe me ndikim të rëndësishëm në zhvillimet e artit tonë bashkëkohor”.**

Duke ju shprehur edhe një herë konsideratën tonë të lartë, imbetemi me besimin se kjo kërkesë do të vlerësohet nga ana Juaj.

Me respekt!



“PLEIN AIR ART ALBANIA”

KRYETARI

Agron POLOVINA

Dokumenti pér dhënie titulli "Qyteti Notu";

2. Sadik Kasa.

Ignor Koceli   
Pozito Peratë   
Amestas Restaurant   
Agnor Pelenino   
Xhemal Kavallari   
Agim Kavallari 



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 312 Prot.

Elbasan, më: 22.01.2025.

R E L A C I O N

*"Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum), lagija "Kongresi Elbasanit" nga Bashkia Elbasan"*

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 "Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit"; i ndryshuar, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore", i ndryshuar, V.K.B Nr. 49 datë 24.05.2021 "Për një ndryshim në V.K.B nr.145 datë 27.11.2020 "Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009", Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.01.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria Buxhet-Financës, "Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum), lagija "Kongresi Elbasanit", nga Bashkia Elbasan";

Subjekti qiramarrës **Znj. Edlira Zhupa** ka bërë kërkesë me nr. 1895 prot., datë 20.11.2024 drejtuar Bashkisë Elbasan (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar sipas V.K.M. nr. 54 datë 05.02.2014) për rinovimin e kontratës për ambjentin (bodrum), Pallati nr.15/1, Lagija "Kongresi Elbasanit" me sipërfaqe  $73.16 \text{ m}^2$ , me tarifë qiraje mujore 200 lekë/ $\text{m}^2$  (si në kontratën e mëparshme), për periudhën 1 (një) vjeçare **nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025** (për t'u përdorur si magazinë). Ky subjekt nuk ka detyrime financiare ndaj bashkisë.

Për sa më sipër, Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria Buxhet-Financës, i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum), lagija "Kongresi Elbasanit" nga Bashkia Elbasan.

KRYETARI  
Gledian Llatja

Me urdhër e porosi

ZV/KRYETAR

Aulona Bylykbashi

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria B.-F:

Drejtoria P.Sh.M:

A. Pisha

A. Suli

A. Merkja

S. Mehmeti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më: \_\_\_\_\_.01.2025.

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ Datë: \_\_\_\_\_.01.2025

**“Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum), lagija “Kongresi Elbasanit” nga Bashkia Elbasan”**

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”; i ndryshuar, V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar; V.K.B Nr. 49 datë 24.05.2021 “Për një ndryshim në V.K.B nr.145 datë 27.11.2020 “Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.01.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria Buxhet-Financës, “Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (bodrum), lagija “Kongresi Elbasanit”, nga Bashkia Elbasan”;

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e dhënies me qira të ambjentit (bodrum), në Pallatin Nr.15/1, Lagjja “Kongresi Elbasanit”, me sipërfaqe 73.16 m<sup>2</sup>, me tarifë qiraje mujore 200 lekë/m<sup>2</sup>, për periudhën 1 (një) vjeçare nga data **01.01.2025** deri më **31.12.2025**, subjektit qiramarrës **Zj. Edlira Zhupa** (për magazinë).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria Buxhet-Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

Konceptoi:: A. Braneshi  
Drejtoria P.P.S:  
Drejtoria P.Sh.M:  
Drejtoria J.I:  
Zv/Kryetar:

**KRYETARI**  
**Lutfi Lala**

A. Pisha  
A. Suli  
S. Mehmeti  
A. Hoxha  
A. Bylykbashi



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 315 Prot.

Elbasan, më: 22.01.2025.

RELACION

*“Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan”*

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; V.K.M Nr. 81 datë 30.01.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bradashesh, të Qarkut të Elbasanit”, i ndryshuar; V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfileozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar; V.K.B Nr. 49 datë 24.05.2021 “Për një ndryshim në V.K.B nr.145 datë 27.11.2020 “Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.01.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria Buxhet-Financës, “*Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan*”;

Subjekti qiramarrës **Znj. Olta Rama** ka bërë kërkesë me Nr. 1995 prot., datë 06.12.2024 drejtuar Bashkisë Elbasan (duke i bashkëlidhur dokumentacionin e kërkuar sipas V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014) për ambjentin (dhomë farmaci) me sipërfaqe  $39.02\text{ m}^2$ , në Njësinë Administrative Bradashesh pranë Qendrës Shëndetësore, me tarifë mujore qiraje 300 leke/ $\text{m}^2$  (si në kontratën e mëparshme), për periudhën 1 (një) vjeçare **nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025** (për t'u përdorur si farmaci). Ky subjekt nuk ka detyrime financiare ndaj bashkisë.

Për sa më sipër, Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria Buxhet-Financës, i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan.

KRYETARI  
Gledian Llatja

Me urdhër e porosi  
ZV/KRYETAR  
Aulona Bylykbashi



Konceptoi: A. Braneshi  
Drejtoria P.P.S:  
Drejtoria B.-F:  
Drejtoria P.Sh.M:

A. Pisha  
A. Suli  
A. Merkja  
S. Mehmeti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më: \_\_\_\_ .01.2025.

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ Datë: \_\_\_\_ .01.2025

*“Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan”*

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”; V.K.M Nr. 81 datë 30.01.2013 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Bradashesh, të Qarkut të Elbasanit”, i ndryshuar; V.K.M Nr. 54 datë 05.02.2014 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurive shtetërore”, i ndryshuar; V.K.B Nr. 49 datë 24.05.2021 “Për një ndryshim në V.K.B nr.145 datë 27.11.2020 “Mbi miratimin e tarifave të ambjenteve që jepen me qira nga Bashkia Elbasan dhe shfuqizimin e V.K.B nr. 24 datë 24.02.2009”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ .01.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria Buxhet-Financës, “Mbi dhënien me qira (rinovim kontrate) të ambjentit (dhomë farmaci), Nj.A. Bradashesh nga Bashkia Elbasan”;

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e dhënies me qira të ambjentit (dhomë farmaci), në Njësinë Administrative Bradashesh pranë Qendrës Shëndetësore, me sipërfaqe 39.02 m<sup>2</sup>, me tarifë qiraje mujore 300 lekë/m<sup>2</sup>, për periudhën 1 (një) vjeçare nga data **01.01.2025** deri më **31.12.2025**, subjektit qiramarrës **Znj. Olta Rama** ( për farmaci ).
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit dhe Drejtoria Buxhet-Financës.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria P.Sh.M:

Drejtoria J.I:

Zv/Kryetar:

A. Pisha

A. Sulj

S. Mehmeti

A. Hoxha

A. Bylykbashi

**KRYETARI**

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 255 Prot

Elbasan më 20/01/2025

RELACION

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë pë muajin DHJETOR 2024

KËSHILLIT BASHKIAK

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjin nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e V.K.B nr 11 datë 23.02.2024 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë"

**Propozojmë:**

1. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin DHJETOR 2024 gjithsej 75 familje me një fond gjithsej 202.880 lekë.  
Këto janë familje shumë të varfëra të cilat nuk kanë mundësi të aplikojnë në sistemin e ndihmës ekonomike pasi për shkaqe të ndryshme sociale, shëndetësore dhe ekonomike, një anëtar madhor nuk është prezent gjatë aplikimit.  
Këto janë raste të grave të braktisura nga bashkëshortët e tyre dhe anasjlltas, familje të cilat kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të shëndetit mendor të cilët largohen nga banesa pa adresë fikse, familje që kanë në përbërje të tyre anëtarë madhorë me probleme të ndryshme sociale (alkooli, droga etj) të cilët nuk janë në gjendje të paraqiten në ditën e aplikimit të ndihmës ekonomike në sistem.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka

Konfirmoi: D.Roseni

Zv/Kryetari

Armand Shehu





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Elbasan më \_\_\_\_ /01/2025

**PROJEKT - VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_ /01/2025

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin DHJETOR 2024**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ /01/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DSHKSK, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i të ardhurave të Bashkisë për muajin DHJETOR 2024 për 75 familje me një fond prej 202.880 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Dr Përgj Kujdesit Social      D.Roseni  
Drejtori Juridik                  A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak  
Elvi Çuni

Kryetari i Këshillit Bashkiak  
Lutfi Lala



BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIAL  
SEKTORI I VLERËSIMIT DHE PAGESAVE TË NDIHMËS EKONOMIKE DHE  
AFTËSISË SË KUFIŽUAR

**INFORMACION KRAHASUES PËR NDIHMËN EKONOMIKE PËR MUAJIN DHJETOR 2024**

**I. Ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Dhjetor 2024**

Dhjetor	247 familje	fondi	1.131.373
Nentor	235 familje	fondi	1.048.503

Për muajin Dhjetor 2024 kemi 12 familje me shume se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i kushtëzuar.

Fondi i shpenzuar është 82.870 lekë më shume se muaji paraardhës.

Familjet e larguara nga ndihma ekonomike nga fondi i kushtëzuar janë:

1. Fatos Kurmaku aplikon ne sistem
2. Petrit Toska aplikon ne sistem
3. Kozeta Dinellari del ne pension(pension familjar nga bashkeshorti)
4. Redinela Boci ka filluar pune
5. Alberto Tomorrica ka bere ndarje te qellimshme per te perfituar ndihme ekonomike
6. Lavdije Kyciku ka filluar pune
7. Angjela Terziu aplikon ne system
8. Klodjana Cepa nuk paraqitet
9. Emine Cekoja del ne pension pleqerie

**II. Ndihma ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin Dhjetor 2024**

Dhjetor	75 familje	fondi	202.880
Nentor	83 familje	fondi	222.000

Për muajin Dhjetor 2024 kemi 8 familje më pak se muaji paraardhes që propozojmë të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Bashkisë.

Fondi është 19.120 lekë më pak se muaji paraardhës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E SHËRBIMIT SOCIAL

Nr.Prot 259

Elbasan më 20/01/2025

RELACION

**Mbi dhënien e Ndihmës Ekonomike nga fondi i Kushtëzuar përmuanin DHJETOR 2024  
KËSHILLIT BASHKIAK**

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike", si dhe bazuar në kriteret e V.K.B. nr. 12 datë 23.02.2024 "Mbi miratimin e kritereve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike", paraqesim per miratim propozimin e familjeve qe do trajtohen nga fondi i kushtezuar.

**I. Të trajtohen me ndihmë ekonomike nga fondi i Kushtëzuar përmuanin DHJETOR 2024 , 247 familje me një fond prej 1.131.373 lekë.**

Këto janë familje të varfra të cilat kanë aplikuar në sistemin e ndihmës ekonomike dhe për shkak se nuk kanë marrë pikët e mjaftueshme, nuk janë kualifikuar përfitues të ndihmës ekonomike nga sistemi i pikëzimit.

Këto janë kryesisht familje me një ose dy antarë. Pra këtu kemi familje të cilat janë me një anëtarë, si femrat ose mëshkujt në moshë të madhe të pamartuar ose të divorcuar, të cilët kanë ose jo një ose dy fëmijë në ngarkim ; personat mbi moshë pune të cilët nuk kanë përfituar pension pleqërie .


Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 "Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike" paragrafi IV pika 11.

Konceptoi: M.Duka

Pranoi: D.Roseni

ZV/KRYETARI

ARMAND SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr \_\_\_\_\_ Prot

Elbasan më \_\_\_\_/01/2025

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ datë \_\_\_\_/01/2025

**Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin DHJETOR 2024**

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ 01/2025 pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga DPPSSHKI, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesëmbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e V.K.B nr. 12 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kritereve të dhënieve së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

**VENDOSI**

1. Të miratojë dhënien e ndihmës ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin DHJETOR 2024 për 247 familje me një fond prej **1.131.373** lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtori Kujdesit Social

D.Rroseni

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Elvi Çuni

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. 316 Prot.

Elbasan, më: 01.01.2025.

R E L A C I O N

*“Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit, ish menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës “ONUFRI”, nga Bashkia Elbasan”*

KËSHILLIT BASHKIAK  
KËTU

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjin Nr. 8580 datë 17.02.2000 V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit, ish menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës “ONUFRI” nga Bashkia Elbasan, si në vijim:

1. Fondacioni “Aid To The Balkans” me NIPT K73222205H me Drejtor Ekzekutiv Znj. Alketa Hasani ka bërë kërkesë nr. 1974 prot., datë 04.12.2024 drejtuar Bashkisë Elbasan (duke i bashkëlidhur dokumentacionin përkatës) për të rinovuar kontratën e Hua Përdorjes pa pagesë të një ambjenti me sipërfaqe 253.2 m<sup>2</sup> (ish menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës “ONUFRI”), ndodhur në Lagjen “Brigada 17 Sulmuese”, për periudhën 1 (një) vjeçare **nga data 01.01.2025 deri më 31.12.2025**, për të kryer aktivitete humanitare të përkujdesit komunitar të shtresave vulnerabël për Rajonin e Elbasanit.

Për sa më sipër, Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit i relaton Këshillit Bashkiak të miratojë dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit ish menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës “ONUFRI” nga Bashkia Elbasan.

KRYETARI  
Gledian Llatja

Me urdhër e porosi  
ZV/KRYETAR  
Aulona Bylykbashi



Konceptoi: A. Braneshi  
Drejtoria P.P.S:  
Drejtoria B.-F:  
Drejtoria P.Sh.M:

A. Pisha  
A. Suli  
A. Merkja  
S. Mehmeti



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më: \_\_\_\_ .01.2025.

**PROJEKT – VENDIM**

Nr. \_\_\_\_ Datë: \_\_\_\_ .01.2025

*“Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit, ish menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës “ONUFRI”, nga Bashkia Elbasan”*

Bazuar në ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligji Nr. 7850 datë 29.07.1994 “Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; V.K.M Nr. 416 datë 11.07.2007 “Për Miratimin e Listës Përfundimtare të Pronave të Paluajtshme Publike, shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Elbasan, të qarkut të Elbasanit”, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_ .01.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit “Mbi dhënien në përdorim (rinovim kontrate) të ambjentit, ish menca e Konviktit të Shkollës së Muzikës “ONUFRI”, nga Bashkia Elbasan”;

**V E N D O S I :**

1. Miratimin e dhënies në përdorim (pa pagesë) të ambjentit me siperfaqe totale 253.2 m<sup>2</sup>, ndodhur në Shkollën e Muzikës “ONUFRI” (godina e ish mencës së konviktit), në Lagjen “Brigada 17 Sulmuese”, Fondacionit “Aid To The Balkans”, për periudhën 1 (një) vjeçare **në data 01.01.2025 deri më 31.12.2025**, për të kryer aktivitete humanitare të përkujdesit komunitar të shtresave vulnerabël në Rajonin e Elbasanit.
2. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Pronave Publike dhe Strehimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

Konceptoi: A. Braneshi

Drejtoria P.P.S:

Drejtoria P.Sh.M:

Drejtoria J.I:

Zv/Kryetar:

A. Pisha

A. Suli

S. Mehmeti

A. Hoxha

A. Bylykbashi

**KRYETARI**  
**Lutfi Lala**



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**

Nr. 313 prot.

Elbasan, më: 22.01.2025.

**R E L A C I O N**

*“Mbi miratimin në parim i mbështetjes financiare për investime në programin social “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, listën e familjeve përfituese si dhe miratimin e deklaratës për bashkëfinancim me MEKI””*

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**KËTU**

Të nderuar Këshilltarë,

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, V.K.M. nr. 454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, Bashkia Elbasan po aplikon pranë Ministrisë Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit për projektet e investimit mbi “Përmirësim i infrastrukturës kryesish në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje (kryesish në zona të banuara nga minoriteti Rom)”, që janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme”, që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2025.

Duke qënë se Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit ka hapur thirrjen për aplikimin mbi programin “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara” për vitin 2025, me kriter bashkëfinancimin me Njësitë e Qeverisjes Vendore, Bashkia Elbasan ka nisur procedurat e zbatimit të këtij programi dhe është në fazën e hartimit të projekteve për “Përmirësim i infrastrukturës kryesish në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje (kryesish në zona të banuara nga minoriteti Rom)”, që janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme”, listën e familjeve përfituese, si dhe miratimin e deklaratës për bashkëfinancim sipas kritereve dhe termave të referencës, përcaktuara nga Ministria e Ekonomisë kulturës dhe Inovacinit, ku Bashkia Elbasan do te financojë në masën 30% të vlerës së projektit “Rikonstruksion i rrugës ekzistuese “Xhaferr Belegu””.

Për sa më sipër, kërkojme aprovimin tuaj për miratimin në parim të mbështetjes financiare për investime në vlerën 30% të programit social “Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje (kryesisht në zona të banuara nga minoriteti Rom)”, që janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme”, listën e familjeve përfituese si dhe miratimin e deklaratës për bashkëfinancim me MEKI të projektit “Rikonstruktion i rrugës ekzistuese “Xhaferr Belegu””.

**KRYETARI**  
**Gledian Llatja**

Me urdhër e porosi

ZV/KRYETAR

Aulona Bylykbashi



Konceptoi: A. Beqiri

Drejtoria P.P.S.:

Drejtoria B. F.:

Drejtoria e P.U:

Drejtoria P.Sh.M:

R. Gremi

A. Suli

A. Merkja

M. Avllazagaj

S. Mehmeti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN

Nr. \_\_\_\_ prot.

Elbasan, më: \_\_\_\_ .01.2025.

**D E K L A R A T Ë**

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, ligjin nr. 22/2018 "Për strehimin social", i ndryshuar, V.K.M. nr. 454 datë 03.07.2019, "Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese", Bashkia Elbasan deklaron financimin në vlerën 30% në shumën 17 134 736. 69 lekë në programin social "Përmirësim infrastrukturës kryesisht në zona informale që janë në proces legalizimi", në bashkëfinancim me Ministrinë e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit në projektin "Rikonstrukcion i rrugës ekzistuese "Xhaferr Belegu""".

Konceptoi : A. Beqiri

B. Korumi

Pranoi : A. Suli

M. Avllazagaj

Miratoi : A. Bylykbashi



**Lista e kryefamiljarëve të rrugës "Xhaferr Belegu"**

Nr	Emër Atësi Mbiemër (Kryefamiljari )	Nr.Total i anëtarëve në familje sipas çertifikatës familjare të 3 muajve të fundit	Kategoria së cilës i përket sipas nenit 16 të ligjit nr.22/2018 I ndryshuar	Niveli i të ardhurave mesatare mujore të familjes	Lloji i dokumentit të pronësisë	Numri i pasurisë dhe zona kadastrale, sipas dokumentit të pronësisë
1	Meritan Meço	4	ç	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
2	Mehmet Meço	4	b/ii	27000 L	Çertifikatë pronësie	8525
3	Ismail Idrizi	2	c/iv	33000 L	Çertifikatë pronësie	8525
4	Pëllumb Idrizi	4	ç	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
5	Ervin Sade	6	c/iv	40000 L	Proçes Legalizimi	8525
6	Fatmir Hyka	6	ç	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
7	Artan Topuzi	4	c/iv	50000 L	Çertifikatë pronësie	8525
8	Dalip Zdrava	2	b/ii	13000 L	Proçes Legalizimi	8525
9	Besnik Sula	3	c/iv	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
10	Shkëlqim Sula	5	c/iv	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
11	Isak Muça	3	ç	5642 L	Proçes Legalizimi	8525
12	Lulzim Rreshka	4	c/i	11680 L	Proçes Legalizimi	8525
13	Hava Rreshka	3	b/ii	17000 L	Proçes Legalizimi	8525
14	Luan Rreshka	5	c/i	11680 L	Proçes Legalizimi	8525
15	Halil Lleshi	2	b/ii	22000 L	Proçes Legalizimi	8525
16	Behar Lleshi	4	ç	5431 L	Proçes Legalizimi	8525
17	Dashamir Lleshi	4	c/iv	40000 L	Proçes Legalizimi	8525

18	Petref	Muça	2	ç	4654 L	Çertifikatë pronësie	8525
19	Ilir	Muça	4	c/iv	45000 L	Çertifikatë pronësie	8525
20	Qani	Muça	4	c/ii	25000 L	Çertifikatë pronësie	8525
21	Bukurije	Topi	1	ç	5646 L	Proçes Legalizimi	8525
22	Luftar	Dyrma	3	c/ii	18000 L	Çertifikatë pronësie	8525
23	Habib	Topi	4	c/iv	33000 L	Proçes Legalizimi	8525
24	Bujar	Duraku	4	c/iv	40000 L	Proçes Legalizimi	8525
25	Mehmet	Duraku	2	ç	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
26	Fatos	Duraku	28	ç	6428 L	Proçes Legalizimi	8525
27	Astrit	Duraku	4	c/iv	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
28	Erjon	Kryemadhi	4	ç	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
29	Ismail	Feza	6	c/iv	53000 L	Proçes Legalizimi	8525
30	Ervis	Xherri	1	c/iv	Familje e varfër pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
31	Azem	Feza	5	c/iv	52000 L	Proçes Legalizimi	8525
32	Ramazan	Xherri	3	c/iv	60000 L	Proçes Legalizimi	8525
33	Islam	Xherri	5	c/i	10800 KMCAP	Proçes Legalizimi	8525
34	Qani	Dyrma	2	c/ii	37000 L	Çertifikatë pronësie	8525
35	Agim	Dyrma	4	c/iv	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
36	Tefta	Dyrma	3	ç	Familje e varfër pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
37	Ilmi	Poka	4		60000 L	Çertifikatë pronësie	8525
38	Alfred	Nuzi	3	ç	6700 L	Proçes Legalizimi	8525
39	Dylejman	Nuzi	2	c/ii	17000 L	Proçes Legalizimi	8525
40	Lavdosh	Bregu	2	ç	8020 L	Proçes Legalizimi	8525

41	Kadri	Sinani	2	c/xi	6500 L	Proçes Legalizimi	8525
42	Ektor	Brahimaj	5	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
43	Naile	Brahimaj	6	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
44	Eles	Brahimaj	6	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
45	Ismail	Poka	4	c/iv	50000 L	Proçes Legalizimi	8525
46	Estref	Brahimaj	2	c/xi	Famile pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
47	Mustafa	Kullolli	4	ç	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
48	Shefit	Gjolena	5	c/iv	42000 L	Proçes Legalizimi	8525
49	Aqif	Gjolena	1	c/iv	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
50	Gëzim	Beqiri	2	ç	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
51	Nebi	Çota	6	c/iv	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
52	Fatos	Halimllari	4	c/xi	6500 L	Çertifikatë pronësie	8525
53	Enverije	Halimllari	1	c/xi	1800 L	Proçes Legalizimi	8525
54	Bajram	Halimllari	2	c/xi	10800 KMCAP 3440 Nd.Ek	Çertifikatë pronësie	8525
55	Behar	Lleshi	4	c/iv	56000 L	Çertifikatë pronësie	8525
56	Dashamir	Lleshi	4	c/iv	40000 L	Çertifikatë pronësie	8525
57	Ilir	Muça	4	ç	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
58	Qani	Muça	4	c/iv	50000 L	Proçes Legalizimi	8525
59	Luftar	Dyrma	3	c/iv	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
60	Feride	Dyrma	4	c/iv	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
61	Festim	Dyrma	4	c/i	KMCAP 11680 L	Çertifikatë pronësie	8525
62	Vladimir	Dyrma	3	c/iv	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525
63	Miranda	Dyrma	3	ç	Familje pa të ardhura	Çertifikatë pronësie	8525

64	Astrit	Dyrma	5	c/ii	25000 L	Proçes Legalizimi	8525
65	Ardjan	Kryemadhi	5	c/iv	51000 L	Proçes Legalizimi	8525
66	Sabri	Skura	2	ç	4000 L	Proçes Legalizimi	8525
67	Renato	Dyrma	3	c/iv	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
68	Ylli	Zerellari	5	c/xi	4500 L	Proçes Legalizimi	8525
69	Ilir	Zerellari	8	c/xi	9800 L	Proçes Legalizimi	8525
70	Albert	Gjolena	4	c/iv	70000 L	Proçes Legalizimi	8525
71	Florida	Malo	4	c/iv	32000 L	Proçes Legalizimi	8525
72	Ylli	Gjolena	3	c/iv	54000 L	Proçes Legalizimi	8525
73	Kujtim	Sinani	2	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
74	Gjergji	Kamberi	7	c/xi	7500 L	Certifikatë pronësie	8525
75	Tomorr	Sinani	8	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
76	Lavdosh	Sinani	3	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
77	Pandeli	Sinani	9	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
78	Përparim	Sinani	13	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
79	Blerina	Sinani	3	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
80	Luan	Bregu	6	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
81	Agron	Zerellari	3	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
82	Mustafa	Kullolli	4	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
83	Pajtim	Zerellari	6	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
84	Fatmir	Zerellari	4	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
85	Mustafa	Zerellari	4	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
86	Besnik	Zerellari	4	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
87	Altin	Abedini	6	c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525

88	Vergjinushe Zerellari		c/xi	Familje pa të ardhura	Proçes Legalizimi	8525
----	-----------------------	--	------	--------------------------	----------------------	------

Administrator i Njësisë Nr.6

Zv/Kryetar

Gëzim Keçi

Aulona Bylykbashi



A handwritten signature in blue ink, appearing to read "Aulona Bylykbashi".



---

REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA ELBASAN  
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më: \_\_\_\_\_.01.2025.

**PROJEKT-VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ Datë \_\_\_\_\_.01.2025.

*“Mbi miratimin në parim i mbështetjes financiare për investime në programin social “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”, listën e familjeve përfituese si dhe miratimin e deklaratës për bashkëfinancim me MEKI””.*

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 22/2018 “Për strehimin social”, i ndryshuar, V.K.M. nr. 454 datë 03.07.2019 “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”, Bashkia Elbasan po aplikon pranë Ministrisë Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit për projektet e investimit mbi programin social “Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje (kryesisht në zona të banuara nga minoriteti Rom)”, që janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj., ose ku këto shërbime janë të papërshtatshme”, që do të financohen nga buxheti i shtetit në vitin 2025. Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës \_\_\_\_\_.01.2025, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan “Mbi miratimin në parim i mbështetjes financiare për investime ne programin social “Përmirësimi i kushteve të banimit për komunitete të varfëra dhe të pa favorizuara”,listën e familjeve përfituese si dhe miratimin e deklaratës për bashkëfinancim me MEKI””;

**V E N D O S I:**

1. Miratimin në parim për financimin në masën 30% të programit social “Përmirësim i infrastrukturës kryesisht në zona informale ku banojnë më shumë se 50 familje (kryesisht në zona të banuara nga minoriteti Rom)”, që janë në proces legalizimi, në zona banimi me mungesë shërbimesh si ujësjellës, kanalizime etj., ose ku këto shërbime janë të

*papërshtatshme*”, listën e familjeve përfituese si dhe deklaratën për bashkëfinancim me MEKI për vitin 2025 të projektit. “Rikonstruksion i rrugës ekzistuese “Xhaferr Belegu””.

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Proanve Publike dhe Strehimit, Drejtoria Projektimit Urban, Drejtoria Buxhet-Financës.
3. Ky vendim hyn ne fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**Lutfi Lala**

*Konceptoi : A. Beqiri*

*Drejtoria P.P.S.:*

*Drejtoria B.F.:*

*Drejtoria e P.U.:*

*Drejtoria P.Sh.M.:*

*Drejtoria J.I.:*

*Zv/Kryetar:*

*R. Gremi*

*A. Suli*

*A. Merkja*

*M. Avllazagaj*

*S. Mehmeti*

*A. Hoxha*

*A. Bylykbashi*



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KULTURËS DHE SPORTIT**  
**Klubi Shumësportesh**

Nr. 247 Prot.

Elbasan, më 20.01.2025

**RELACION**

***“Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2025”***

**KËSHILLIT BASHKIAK**

**Këtu**

**Të nderuar këshilltarë!**

Klubi Shumësportesh është një institucion vartës i Bashkisë Elbasan. Ky klub është dalluar në shkallë kombëtare dhe ndërkombëtare për rezultatet e larta në shumë disiplina sportive, sporte të cilat mbështeten nga financimi i Bashkisë Elbasan për stafin teknik dhe mbështetjen për sportistët.

Për sezonin sportiv vjetor **2025**, përmes klubit, Bashkia Elbasan do të mbështesë **20** disiplina sportive me **40** ekipe dhe **37** trajnerë (3 sporte kolektive si: basketbolli, volejbolli dhe hndbolli; 17 sporte individuale si: karate, peshëngritje, alpinizëm, çiklizëm, ping - pong, atletikë, judo, snooker, qitje, radioamatorizëm, boks, not, hipizëm, mundje, *shah, rafting, hark (tre sportet e fundit janë në kuadrin e masivizimit, si pjesë e Klubit Shumësportesh, pa buxhet, në proces të plotësimit të dokumentacionit si OJF)*, për grupmosha të ndryshme, ku trajnerët trajtohen me honorare dhe sportistët me trajtim ushqimor.

Përmirësimi i performancës në administrimin e klubit, me qëllim rritjen e performancës sportive të tij, përbën edhe sfidën më të madhe në drejtim të zhvillimit të sportit në territorin e Bashkisë Elbasan.

Referuar në ligjin nr. 79/2017 “Për sportin” (i ndryshuar), mbështetur dhe në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar) si dhe në ligjin nr. 68/2017 “Për finansat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar), i relatojmë Këshillit Bashkiak të miratojë “*Ekipet sportive dhe trajnerët përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2025*”, si më poshtë:

<b>Nr.</b>	<b>Disiplinat Sportive / Ekipet</b>	<b>Trajner</b>	<b>Nr. i sportistëve</b>
	<b>VOLEJBOLL</b>		<b>24</b>
1	Të Rritur	1	12
2	Shpresat (m)	1	-

3	Të Rinj	1	-
4	Të Ritura	1	12
5	Shpresat (f)	1	
6	Të Reja	1	-
<b>BASKETBOLL</b>			<b>24</b>
7	Të Rritur	1	12
8	Shpresat (m)	1	-
9	Të Rinj	1	-
10	Të Ritura	1	12
11	Të Reja	1	-
<b>HENDBOLL</b>			<b>7</b>
12	Të Rritur (M)	1	7
13	Të Ritura (F)	1	-
<b>KARATE</b>			<b>13</b>
14	Të Rritur	1	5
15	Të Rinj	1	4
16	Të Ritura / Të Reja	1	4
<b>PESHËNGRITJE</b>			<b>13</b>
17	Të Rritur	1	5
18	Të Rinj	1	4
19	Të Ritura / Të Reja	1	4
<b>ALPINIZËM</b>			<b>5</b>
20	Të Rritur (M & F)	1	5
<b>ÇIKLIZËM</b>			<b>7</b>
21	Të Rritur	1	5
22	Të Rinj	1	2
<b>PING - PONG</b>			<b>8</b>
23	Meshkuj	1	4
24	Femra	1	4
<b>ATLETIKË</b>			<b>8</b>
25	Të Rritur	1	2
26	Të Rinj	1	2
27	Të Ritura	1	2
28	Të Reja	1	2
<b>QITJE</b>			<b>4</b>
29	Meshkuj	1	3
30	Femra	1	1

	<b>SNOOKER</b>		<b>1</b>
31	Të Rritur	1	1
	<b>JUDO</b>		<b>3</b>
32	Meshkuj	1	3
	<b>RADIOAMATORIZËM</b>		<b>2</b>
33	Meshkuj & Femra	1	2
	<b>BOKS</b>		<b>3</b>
34	Meshkuj	1	3
	<b>NOT</b>		<b>3</b>
35	Meshkuj & Femra	1	3
	<b>HIPIZËM</b>		
36	Meshkuj	1	-
	<b>MUNDJE</b>		
37	Meshkuj	1	-
	<b>HARK</b>		
38	Meshkuj	-	-
	<b>SHAH</b>		
39	Meshkuj	-	-
	<b>RAFTING</b>		
40	Meshkuj	-	-

Duke ju falenderuar!

Konceptoi:

Drejtori i Klubit Shumësportesh:

*M. Backa*  
M. Backa, 2025


Miratoi:

Drejtori i Përgjithshëm i DPKS:

*A. Kovaçi*

ZV/KRYETARI

Asim Sula





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më \_\_\_\_\_.01.2025

**PROJEKT VENDIM**

Nr. \_\_\_\_\_ datë \_\_\_\_\_.01.2025

***“Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2025”***

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e datës \_\_\_\_\_.01.2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Klubi Shumësportesh i Bashkisë Elbasan “Për miratimin e ekipeve sportive dhe të trajnerëve përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2025”, mbështetur në:

- a) Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” (i ndryshuar);
- b) Ligjin nr. 79/2017 “Për sportin” (i ndryshuar);
- c) Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” (i ndryshuar);

**VENDOSI:**

1. Të miratojë ekipet sportive dhe trajnerët përkatës të Klubit Shumësportesh, Bashkia Elbasan, për sezonin sportiv vjetor 2025, si mëposhtë:

<b>Nr.</b>	<b>Disiplinat Sportive / Ekipet</b>	<b>Trajneri</b>	<b>Nr. i sportistëve</b>
<b>VOLEJBOLL</b>			
1	Të Rritur	1	12
2	Shpresat (m)	1	-
3	Të Rinj	1	-
4	Të Rritura	1	12
5	Shpresat (f)	1	-
6	Të Reja	1	-
<b>BASKETBOLL</b>			
7	Të Rritur	1	12
8	Shpresat (m)	1	-
9	Të Rinj	1	-
10	Të Rritura	1	12

11	Të Reja	1	-
	<b>HENDBOLL</b>		7
12	Të Rritur (M)	1	7
13	Të Ritura (F)	1	-
	<b>KARATE</b>		13
14	Të Rritur	1	5
15	Të Rinj	1	4
16	Të Ritura / Të Reja	1	4
	<b>PESHËNGRITJE</b>		13
17	Të Rritur	1	5
18	Të Rinj	1	4
19	Të Ritura / Të Reja	1	4
	<b>ALPINIZËM</b>		5
20	Të Rritur (M & F)	1	5
	<b>ÇIKLIZËM</b>		7
21	Të Rritur	1	5
22	Të Rinj	1	2
	<b>PING - PONG</b>		8
23	Meshkuj	1	4
24	Femra	1	4
	<b>ATLETIKË</b>		8
25	Të Rritur	1	2
26	Të Rinj	1	2
27	Të Ritura	1	2
28	Të Reja	1	2
	<b>QITJE</b>		4
29	Meshkuj	1	3
30	Femra	1	1
	<b>SNOOKER</b>		1
31	Të Rritur	1	1
	<b>JUDO</b>		3
32	Meshkuj	1	3
	<b>RADIOAMATORIZËM</b>		2
33	Meshkuj & Femra	1	2

	<b>BOKS</b>		<b>3</b>
34	Meshkuj	1	3
	<b>NOT</b>		<b>3</b>
35	Meshkuj & Femra	1	3
	<b>HIPİZËM</b>		
36	Meshkuj	1	-
	<b>MUNDJE</b>		
37	Meshkuj	1	-
	<b>HARK</b>		
38	Meshkuj	-	-
	<b>SHAH</b>		
39	Meshkuj	-	-
	<b>RAFTING</b>		
40	Meshkuj	-	-

2. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Kulturës dhe Sportit, Klubi Shumësportesh dhe Drejtoria e Buxhet - Financës në Bashkinë Elbasan, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

**SEKRETARI**

**Elvi Çuni**

**KRYETARI**

**Lutfi Lala**

Konceptoi:

Drejtor i Klubit Shumësportesh:

*M. Backa*

Pranoi:

Drejtor i Përgjithshëm i Kulturës dhe Sportit: *A. Kovaçi*

Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Informacionit: *A. Hoxha*

Miratoi:

Drejtor i Drejt. Prgjithsh. Ardh. Buxh. e Fin.: *G. Dyrmyshi*

Konfirmoi:

Zv/kryetari:

*A. Sula*

Zv/kryetari:

*A. Bylykbashi*



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**BASHKIA ELBASAN**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KULTURËS DHE SPORTIT**

Adresa: Lagja 28 Nentori, prane Pallatit te Sportit "Tomorr Sinani"

Nr 286 Prot

Datë 21 / 01 / 2025

### RELACION

**"Për miratimin e dhënies me qira te ambjenteve në godinën e pallatit të sportit "Tomorr Sinani",  
në lagjen "28 Nëntori", nga Bashkia Elbasan"**

**Drejtuar: Këshillit Bashkiak**

**Të nderuar Këshilltarë !**

Prej disa vitesh, disa nga ambjentet e brëndshme të ndërtesës së Pallatit të Sportit "Tomorr Sinani", u janë dhëne me qira subjekteve private. Në këtë mënyre Klubi Shumësportesh ka përfituar te ardhura të cilat i ka vëne në shërbim të plotësimit të nevojave te tij për një zhvillim sa më normal të aktiviteteve.

Nga ana tjetër subjektet qiramarrëse i kanë përdorur këto ambjente brenda kritereve ligjore ( të përcaktuara edhe në kontratat dypalëshe), për aktivitete te ndryshme private kundrejt një pagese qiraje mujore të përcaktuar rigorozisht, bazuar në legjislacionin përkatës.

